



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 6484 prot.

Himarë, më 19.08.2025

VENDIM

Nr. 43 , Datë 13/08/2025

PËR

**“DHËNIEN E MIRATIMIT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM PËR NJË AFAT 3
(TRE) VJEÇAR, NGA FONDI PYJOR KULLOSOR TË NJË SIPËRFAQE PREJ 5
HA, NR.PASURIE 2/78 , ZK:3844 NË FAVOR TË SHOQËRISË
“SOLEIL&SEA”SH.P.K.”**

AKTIVITETI:

**“SHFRYTËZIM PËR PARKIM TË AMBJENTIT PËR MAKINERITË E INERTEVE,
PËR NEVOJA TË KOMPANISË”**

Bazuar ne ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 9, pika 1.2; neni 27, pika 5 dhe nenit 54; VKM nr. 433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish- komunave/bashkive”, ligjin 57/2020, date 30.04.2020 “Për Pyjet”, neni 5; VKM nr. 592, datë 09.10.2018 "Për disa ndryshime në VKM nr.1354, date 10.10.2008 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave, që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullorosor”; V.K.M-në nr.888, datë 27.12.2022, “Për rastet e dhënies në përdorim dhe për ndryshimin e kategorisë së përdorimit , procedurat dhe dokumentacioni përkatës për ndryshimet e sipërfaqeve dhe pakësimin në volum nga fondi pyjor kombëtar apo zgjerimin e tyre; me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë: Këshilli i Bashkisë Himarë pasi shqyrtoi materialin e sjellë nga Kryetari Bashkisë e miratoi me pesëmbëdhjetë (15) vota pro, dy (2) kundër , zero (0) abstenim dhe si më poshtë,

VENDOSI:

1. Dhënie e miratimit për dhënie në përdorim për një afat 3 (tre) vjeçar, nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 5 HA, NR.PASURIE 2/78 , ZK:3844 në favor të shoqërisë "SOLEIL&SEA"SH.P.K." për aktivitetin "Shfrytëzim për parkim të ambjentit për makineritë e inerteve, për nevoja të kompanisë".
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për nënshkrimin e "Kontratës për dhënie në përdorim nga fondi pyjor kullosor të një sipërfaqe prej 5 HA, NR.PASURIE 2/78 , ZK:3844 në favor të shoqërisë "SOLEIL&SEA"SH.P.K." për aktivitetin "Shfrytëzim për parkim të ambjentit për makineritë e inerteve, për nevoja të kompanisë"..
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar ne Ligjin nr. 139/2015 " Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 55 pika 6.

KRYETARI
Dhimitër Kapa

